



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:086024
Datë: 01.11.2023
Numri i dokumentit: 04861743

PPP.nr.99/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përbarimore të kreditorit F. SH.P.K, me seli në Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson përfaqëson Sh.Q., e këtë me autorizim e përfaqëson av Edison Simani nga Vitia, kundër debitorit B.B. nga Ferizaj, rr "...", nr....., për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 01.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit B.B., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.83/22, i datës 06.04.2022, i lëshuar nga përbaruesi privat P.Xh. nga Gjilani dhe **MBETET në fuqi** urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.83/22, i datës 06.04.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.83/22, të datës 06.04.2022, përbaruesi privat P.Xh., e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit F. SH.P.K, kundër debitorit B.B., për detyrimin e debitorit, për pagesën e borxhit në emër të shitblerjes së banesës në shumë prej 41,850 euro, në bazë të Para Kontratës për Shitblerjen e Paluajtshmërisë - Banesës me numër LRP.nr.1.../2018 dhe REF.nr.5.../2018, të datës 30.05.2018, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar, ndërsa urdhri për caktimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim P.nr.83/22, i datës 06.04.2022, i lëshuar nga përmbaruesi privat P.Xh., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat e ka nxjerrë urdhrin për përmbarim duke e lejuar përmbarimin në pajtim të plotë me nenin 22, par 1, nën par 1.3, të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se: debitori e kundërshton borxhin sipas propozimit për arsye se ky borxh është kompensuar me Bager të tipit Fiat Hitach 35 ton, viti i prodhimit 1998, si dhe përfaqësuesit të debitorit, Sh.Q., në prani të dëshmitarëve dhe noteres ku është lidhur para kontrata, i janë dhënë para kesh 12,500.00 euro, provë dëgjimi i dëshmitarëve, gjykata këtë pretendim të debitorit e konsideron të pa bazuar sepse siç konstatohet nga shkresat e lëndë, përkatësisht nga prapësimi i debitorit, i njëjti nuk i ka bashkangjitur asnjë provë me shkrim, në bazë të cilës do të vërtetohej pretendimi i debitorit se kreditorit nga shuma e borxhit prej 41,850.00 euro, i ka paguar shumën e mjeteve prej 12,500 euro. Për në tepër në nenin 69, par 4, të LPP-së, është paraparë shprehimisht me ligj se: “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Përveç tjerash, gjykata konsideron se propozimi i debitorit për dëgjimin e dëshmitarëve në këtë çështje juridike përmbarimore është i pa bazuar dhe jo i ligjshëm, për arsye se gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, gjykata nuk ka të drejtë dhe kompetencë të bëjë dëgjimin e dëshmitarëve dhe të administroj prova, sepse një gjë e tillë mund të bëhet vetëm në procedurën kontestimore të ngritur përmes padisë eventuale të ushtruar nga debitori kundër

kreditorit, për vërtetimin e shumës së borxhit në fjalë. Përndryshe gjykata në këtë rast ka për detyrë dhe kompetencë vetëm ta bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së urdhrit për përmbarrim të nxjerrë nga përmbarruesi privat.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit tjetër të debitorit në prapësim se: procedura është filluar në kundërshtim me nenin 22, të LPP-së, sepse para kontrata nuk paraqet titull ekzekutiv në procedurën përmbarrimore, dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarrues ose urdhri përmbarrues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse në rastin konkret Përmbarruesi Privat P.Xh., urdhrin për përmbarrim P.nr.83/22, të datës 30.03.2022, e ka nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 22, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, sepse në dispozitën ligjore të cekur më lart është paraparë shprehimisht se si dokument përmbarrimor në bazë të cilit mund të caktohet përmbarrimi nga organi përmbarrues është edhe kontrata e noterizuar tek noteri. Po ashtu, në nenin 43, par 1, të Ligjit Nr.06/L-010, për Noterinë, është përcaktuar shprehimisht se: “Dokumenti noterial është dokument përmbarrimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përmbarrimi i detyrueshëm”, dhe në bazë të aktit noterial, para kontratës në fjalë, përkatësisht në nenin 6, të saj palët janë pajtuar me vullnetin e tyre të lirë që para kontrata të jetë dokument ekzekutiv, respektivisht është paraparë se: Ky akt en minutën ka fuqinë provuese dhe ekzekutuese.

Po ashtu, sa i përket pretendimeve të debitorit se kërkesa e kreditorit ndaj debitorit është parashkruar sepse kanë kaluar më tepër se tre vite nga dita e nënshkrimit të para kontratës, dhe së bashku me propozimin për përmbarrim organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues në origjinal apo kopje e vërtetuar, gjykata edhe këto pretendime i konsideron të pabazuara, sepse në nenin 355, par 1, të LMD-së, është paraparë shprehimisht se kërkesat reciproke nga kontratat komerciale dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite, dhe nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga Para Kontrata për Shitblerjen e Paluajtshmërisë – Banesës, LRP.nr.1.../2018 dhe REF.nr.5.../2018, të datës 30.05.2018, përkatësisht nenit 2 të saj, palët janë pajtuar se çmimi i shitblerjes do të paguhet brenda një viti, që nënkupton se kreditori kërkesën për përmbarrim, propozimin për përmbarrim e ka ushtruar pas kalimit të afatit vullnetar, gjegjësisht pas datës 30.05.2019, data

në të cilën ka qen afati i fundit për pagesën e shumës së borxhit nga debitori ndaj kreditorit dhe nëse llogaritet koha prej datës 30.05.2019 e deri më datën 06.04.2022, rrjedh se kreditori propozimin për përmbarim e ka ushtruar tek përmbaruesi privat brenda periudhës kohore prej tre viteve, dhe duke e marr për bazë faktin e cekur më lart, del se kërkesa e kreditorit nuk është parashkruar, vjetërsuar, dhe rrjedhimisht nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 355, par 1, të LMD-së. Për më tepër nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori para kontratën e cekur më lart e ka dorëzuar tek përmbaruesi privat në kopje të vërtetuar tek noteri, dhe me këtë janë plotësuar edhe kushtet ligjore nga neni 36, par 1, të LPP-së.

Po ashtu, gjykata konstaton se kontrata e përmendur më lart është në tërësi e përshtatshme për përmbarim, respektivisht në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, për arsye se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Si përfundim, kjo gjykatë, duke i marrë parasysh të gjitha faktet e cekura më lart, pretendimet e debitorit në prapësim, përgjigjen e ushtruar në prapësimin e debitorit nga i autorizuari i kreditorit, si dhe provat në lëndë, gjeti se prapësimi i debitorit, i ushtruar kundër urdhrit për përmbarim P.nr.83/22, të datës 06.04.2022, është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.99/22, më datë 01.11.2023

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.